



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRES
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I TURIZMIT

Nr. 227/prot.
/9

Durrës, më 13/5/2026

V E N D I M D E P A R T A M E N T I

Nr. 6 Datë 12. 5.2025

P Ë R

**"MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË PROJEKTIT KËRKIMOR PËR PROGRAMIN
E STUDIMIT TË DOKTORATËS PRANË DEPARTAMENTIT TË TURIZMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe rregulloret e UAMD për programin e Ciklit të tretë të studimit "Doktoraturë në Shkenca Ekonomike", Departamenti i Turizmit vendosi miratimin e kriterëve dhe të pikëzimit për vitin akademik 2025-2026, si vijon:

I. Kriteret e pranimit për kandidatet e doktoratës.

- 1) Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Turizem, Shkencave Ekonomike ose të përafërta me to.
- 2) Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit sebashku (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND) me notë mesatare të ponderuar 8 (tetë) e lart.
- 3) Në rast se aplikanti ka mbi 10 (dhjete) vite si lektor me kohe të plote në procesin e mesimdhënies, kandidati përjashtohet nga kriteri i mesatares.
- 4) Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.
- 5) Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të Shkencave Ekonomike ose në fusha të përafërta.
- 6) Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 7) Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar nga udhëheqësi.
- 8) Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- 9) Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës nga profesorë të cilët njohin

eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.

- 10) Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike ose te perafërta me to.
- 11) Kandidati duhet të kenë eksperiencë të paktën 2 (dy) vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një Institucion të Arsimit të Lartë, apo Institucione të kërkimit bazë ose të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës

II. Metodologjia e vleresimit (Pikezimi)

Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Shkencave Ekonomike

a. Diploma e fituar, kriteri (a)	<u>(maksimumi 400 pikë)</u>	
i. Bachelor në Turizem		200 pikë
ii. Master Shkencor në Turizem		200 pikë
iii. Bachelor, programe të përafërta		150 pikë
iv. Master Shkencor, programe të përafërta		150 pikë
b. Nota mesatare, kriteri (b)	<u>(maksimumi 250 pikë)</u>	
i. 9.51 – 10.00		250 pikë
ii. 9.01 – 9.50		210 pikë
iii. 8.51 – 9.00		180 pikë
iv. 8.00 – 8.50		150 pikë
c. Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e)	<u>(maksimumi 200 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa një gjuhë e huaj		200 pikë
ii. Një gjuhë e huaj		150 pikë
d. Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j)	<u>(maksimumi 150 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa 2		150 pikë
ii. Deri në 2		100 pikë

DREJTUESI I NJËSISË BAZË

Prof.Asoc.Dr. Mirela Tase

